



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA
TIRANË

URDHER

“Për ndalimin e publikimit të akteve”

Në Tiranë, sot më datë 05.06.2019, ne Prokurorët Dritan Prençi dhe Vladimir Mara, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, pasi jemi njohur me publikimin e pjesshëm në disa media elektronike të disa akteve hetimore përfshi dhe përgjime audio, të kryera në kuadër të proçedimit penal Nr.339, të vitit 2016;

KONSTATUAM:

Më datë 27.12.2016, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, është regjistruar proçedimi penal Nr.339, lidhur me veprat penale të “Trafikim i narkotikeve” kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/a/2 të K.Penal.

Pas një hetimi proaktiv deri në muajin tetor 2018, i jemi drejtuar me kërkesë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për caktimin e masave të sigurimit personal për një numër të konsideruar shtetasish të dyshuar se kanë kryer veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/2, 333/a, etj, të K.Penal, të njohur ndryshe dhe si “Operacioni Vol Vo4”.

Menjëherë pas caktimit të masave të sigurimit personal nga gjykata dhe ekzekutimit të tyre nga Policia e Shtetit, media të ndryshme kanë publikuar disa transkriptime të realizuara në kuadër të këtij hetimi, dhe së fundmi, edhe përgjime audio, të cilat na bëjnë të besojmë se kanë dalë nga kopjimi ose regjistrimi i bisedave që gjenden në CD-të bashkëlidhur akteve të këtij proçedimi penal.

Nisur nga fakti se publikimi i akteve të mësipërme, çënojnë sekretin e hetimit paraprak lidhur me proçedimin penal Nr.339, të vitit 2016, i cili nuk ka përfunduar akoma, ç`moj se duhet ndaluar publikimi i tyre nëpërmjet shtypit ose çdo lloj forme tjetër informacioni masiv.

Në këto kushte, bazuar në kërkesat e neneve **103, 104 dhe 105 të K.Pr.Penale;**

URDHEROJME

1.Ndalimin e publikimi të akteve të proçedimit penal Nr.339, të vitit 2016, nëpërmjet shtypit ose çdo lloj forme tjetër informacioni masiv.

2. Ngarkohet me ekzekutimin e këtij urdhëri Kordinatori për Mediat në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

3. Subjektet e proçedimit penal, avokatët mbrojtës, etj, të cilët për shkak të cilësisë së tyre njihen me aktet e proçedimit penal Nr.339, të vitit 2016, ndalohen t'i bëjnë publike ato.

4. Shkelja e këtij urdhëri, personat përgjegjës i ngarkon me përgjegjësi penale, sipas nenit 295/a/3 të K.Penal.

PROKURORET
Dritan PRENÇI **Vladimir MARA**

